



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

Nr. 454 prot.

Elbasan, më 17.02.2021

VENDIM

Nr 05 datë 17.02.2021

**"PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES SË MODALITETEVE TË ZHVILLIMIT TË  
PROVIMEVE TË SEZONIT TË PARË TË VITIT AKADEMIK 2020-2021,  
NË UNIVERSITETIN E ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015 datë 22.07.2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet publike të arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, germa "d", Statutit të UE-së, neni 9, germa "d", Rregulloren e Studimeve në UE-së, bazuar edhe në rekomandimin e MASR, shkresa Nr. 749/25 prot, datë 11.2.2021, me propozim të Rektoratit të UE-së, Senati Akademik,

**V E N D O S I:**

1. Të miratojë Rregulloren e Modaliteteve të Zhvillimit të Provimeve të sezonit të parë të vitit akademik 2020-2021, në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Kjo Rregullore i shtrin efektet vetëm për provimet e sezonit të parë të vitit akademik 2020-2021.
3. Të gjitha aktet e tjera normative në fuqi, që rregullojnë procesin e zhvillimit të provimeve në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" (rregulloret e studimeve), për periudhën e sezonit të parë të vitit akademik 2020-2021, nuk do të kenë efekt për aq sa bien në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje.
4. Ngarkohen të gjitha fakultetet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



**KRYETARI**

**Prof. Dr. Skender TOPI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"  
SENATI AKADEMIK

**RREGULLORE**

**Për**

**Modalitetet e Zhvillimit të Provimeve të sezonit të parë të vitit akademik 2020-2021,**

**në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani"**

1. Provimet e sezonit të parë të vitit akademik 2020-2021, në Fakultetet e Universitetit e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" të zhvillohen të kombinuara: provime në auditor me praninë fizike të studentëve dhe provime online me praninë virtuale të studentëve.
2. Lëndët, provimet e të cilave do të zhvillohen online, si dhe ato që do të zhvillohen në auditor do të përcaktohen nga vetë Fakulteti, duke marrë në konsideratë llojin e lëndës, mundësinë e studentëve për të marrë pjesë virtualisht në këto provime, si dhe numrin e kapacitetin mbajtës të sallave të secilit Fakultet.
3. Provimet do të zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin e provimeve të miratuar nga Dekanati me propozim të departamenteve, duke konsideruar modalitetet e kësaj Rregulloreje. Datat e provimeve të publikohen në faqen zyrtare elektronike të IAL-së dhe në mjedisit e secilit fakultet të paktën një javë përpara zhvillimit të tyre.
4. Sezoni i provimeve do të zgjasë jo më pak se 4 javë dhe jo më shumë se 6 javë.
5. Studentët që për arsye të pamundësive që krijon situata Covid-19, apo arsye të tjera objektive, nuk kanë mundësi të japin provimin në datën e caktuar do të kenë një mundësi të dytë për ta dhënë të njëjtin provim, jo më pak se 2 javë më vonë.
6. Pavarësisht nivelit të frekuentimit të seminareve apo leksioneve online, studentët do të kenë të gjithë mundësinë të futen dhe të japin provim në këtë sezon.
7. Titullarët e çdo lënde, për të cilin studenti jep provim, pavarësisht parashikimeve të bëra në programin (syllabusin) e lëndës, janë të lirë të përcaktojnë raportin mes tre përbërësve të vlerësimit përfundimtar (vlerësimit **të vazhduar, të ndërmjetëm dhe të provimit**), duke mbajtur parasysh specifikat e zhvillimit të lëndës përkatëse në sistemin online.
8. Tezat e provimit hartohen nga titullari i lëndës/modulit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit përpara zhvillimit të provimit. Në rastet kur provimi do të zhvillohet online, nëpërmjet pyetësorëve online (p.sh. google forms,



REPUBLIKA E SHQIPERISË

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**SENATI AKADEMIK**

- microsoft forms etj.) do të hartohen dhe miratohen paraprakisht pyetjet që do të përmbajë pyetëtori.
9. Studenti paraqitet në provim në auditor i pajisur me dokument identifikimi (librezë studenti, kartë identiteti ose pasaportë). Në provimin online, studenti duhet të paraqesë virtualisht të njëjtat dokumente si më sipër për të bërë të mundur verifikimin e tij nga pedagogu. Në rast të kundërt, studenti nuk lejohet të marrë pjesë në provim.
  10. Provimet që do të zhvillohen online, do të realizohen përmes platformës virtuale Microsoft Teams. Titullarët e çdo lënde, për të cilin studenti jep provim on line, pavarësisht parashikimeve të bëra në programin (syllabusin) e lëndës, duke mbajtur në konsideratë specifikat e lëndës dhe mundësitë që të afron platforma virtuale, janë të lirë të përcaktojnë formën e zhvillimit të provimit: me gojë, me shkrim, apo të kombinuar me gojë dhe më shkrim. Studentët, si rregull, merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës.
  11. Provimet që do të zhvillohen në auditor (me prani fizike të studentëve) do të realizohen sipas përcaktimeve në programin (syllabusin) e lëndës, në dy mënyra (a) me shkrim, (b) me gojë.
  12. Përcaktimi i sallave ku do të zhvillohen provimet në auditor, si dhe numri i studentëve që mund të jenë të pranishëm në sallë, do të bëhet nga çdo fakultet, duke respektuar rregullat e distancimit Covid-19. Në çdo rast, për provimet në auditor, pavarësisht kapacitetit mbajtës të sallës, në të njëjtën sallë nuk mund të qëndrojnë më shumë se 15 persona. Çdo fakultet do të përcaktojë gjithashtu mënyrën e lëvizjes së studentëve në mjediset e fakultetit për t'u futur dhe dalë nga salla ku zhvillohet provimi në auditor. Në çdo rast studentët nuk mund të qëndrojnë të grumbulluar në mjediset e fakultetit.
  13. Provimet që do të zhvillohen në auditor më shkrim do të zgjasin jo më shumë se një orë (60 minuta) dhe më pas salla apo mjedisi ku zhvillohet provimi do të dezinfektohet dhe ajroset për jo më pak se 1 orë (60 minuta). Provim tjetër në të njëjtin mjedis nuk mund të zhvillohet pa kaluar 2 orë nga zhvillimi i provimit të parë. Departamentet e çdo fakulteti të UE-së, në rastet kur numri i studentëve është i madh, të marrin masa për të ngarkuar me monitorimin e provimeve me shkrim, të gjithë pedagogët e mundshëm të fakultetit përkatës, pavarësisht nëse janë anëtarë të atij departamenti apo jo.
  14. Provimet që do të zhvillohen në auditor më gojë do të zgjasin për aq kohë sa duhet për të përfunduar të gjithë studentët, duke respektuar në çdo rast numrin maksimal të lejuar të personave të pranishëm në sallë (15 persona). Kohëzgjatja



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**SENATI AKADEMIK**

e provimit me gojë (dëgjimit të përgjigjes së studentit) është 10 (dhjetë) minuta, për çdo student. Studentët, si rregull, merren në provim nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës.

15. Vlerësimet e studentëve pasqyrohen brenda 6 ditëve nga zhvillimi i provimit, në Sistemin e Menaxhimit të të Dhënave të UE-së (sistemi online). Procesverbali, i plotësuar me rezultatin e provimit, i gjeneruar nga sistemi i menaxhimit të të dhënave, dorëzohet në sekretarinë mësimore i nënshkruar nga komisioni përkatës, brenda 6 ditëve nga zhvillimi i provimit. Studentët që nuk kanë mundësi të jenë të pranishëm (në auditor apo online) ditën e provimit do të kenë mundësi të zhvillojnë të njëjtin provim në datën tjetër që do të miratohet për atë provim. Për çdo provim do të hartohen dhe miratohen jo më shumë se dy procesverbale (një procesverbal për çdo datë provimi).
16. Për procedurat e zhvillimit të provimeve nga stafi akademik do të zbatohen edhe dispozitat e rregulloreve në fuqi në UE dhe në fakultetet përkatëse, për aq sa ato nuk bien ndesh me dispozitat e mësipërme.

**Miraturar me Vendim të senatit Akademik Nr. 05 datë 17.02.2021**

